



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.28/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.28/2025 e datës 13.01.2025
- II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 20,000.00 (njëzetmijë) euro.
- III. Detyrohet Subjekti Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 13.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), me të cilën pretendon se kandidatja për deputete nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, (LDK) Xheneta Syka, me anë të një shpërndarje të videos, ka krahasuar Kryeministrin Albin Kurti me njërin nga figurat më të urryera të historisë atë të Adolf Hitler, gjatë udhëheqjes të së cilit janë vrarë mbi 6 milionë njerëz të pafajshëm.

Sipas parashtruesit të ankesës me këtë veprim kandidatja Xheneta Syka ka cenuar rëndë nenin 34. pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës i cili shprehimisht thotë “përdorimi i gjuhës në formën e shkruar ose gojore, qe nxit ose provokon, ose që mund të nxis ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxis urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose

përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”

Me këtë parashtruesi i ankesës pretendon se kandidatja për deputete nga radhët e LDK-së Xheneta Syka, ka cenuar rëndë nenin 34 pika 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke përdorur gjuhë të urrejtjes kundër kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, njehërit Kryeministër i Republikës së Kosovës, z.Albin Kurti.

Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesë, ka bashkangjitur si provë një fotografitë dhe video me linkun <https://www.facebook.com/watch/?v=476104568865360> në cilësi të provës materiale.

Më datë 13.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 14.01.2025 në ora 12:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 14.01.2025, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje i cili pretendon se kandidatja për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, znj.Xheneta Syka, ka shkelur nenin 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 të LZP-së, nuk qëndron ngase origjina apo burimi i një fotoje të bashkangjitur në ankesën e subjektit politik LVV, është e përpunuar dhe postuar nga krejt dikush tjetër (konkretisht një person me emrin Elena Uka) dhe jo nga kandidatja për deputete nga radhët e LDK-së, dhe se është një gabim në pretendim e që praktikisht i bie që nuk ka as shkelje të LZP-së dhe nenit të pretenduar e kesisoj sigurisht se nuk mund të ketë as mase sanksionuese.

Poashtu në përgjigje në ankesë theksohet se në faqen zyrtare të kandidates për deputete nga LDK znj.Xheneta Syka nuk ekziston një foto e tillë, sepse ajo është e përpunuar dhe postuar nga një person krejt tjetër, çka vërehet edhe nga postimet e saj në faqen zyrtare të rrjetit social facebook dhe të cilat i keni të bashkangjitura në përgjigje.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, pas shikimit të bërë fotografisë së ofruar si provë materiale e cila është publikuar në rrjetin social të mbështetëses se subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës kandidates për deputete Xheneta Syka nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, LDK, dhe me pas e njëjta fotografi është fshirë nga rrjeti social i kandidates për deputete Xheneta Syka por e njëjta foto nga hulumtimet e Panelit është gjendur se ekziston në portalin Peja në Fokus me linkun <https://www.instagram.com/reel/DEvfN-LtztU/?igsh=MTB1ZnZ2NjNzGpA==> , prej nga rrjedh se mbështetësja e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK, me qëllim të etiketimit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje dhe promovimit të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka nxitur urrejtje ndaj subjektit politik LVV, në atë mënyrë që përmes rrjetit social ka publikuar, përkatësisht shpërndarjen në faqen e saj të rrjetit social video ku në këtë video, është bërë krahasimi i personalitetit të kryetarit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me figurën e Adolf Hitlerit.

Paneli, konform nenit 13 par. 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 01/2014, me datë 14.01.2025, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara.

Përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenit 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... 1) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së thekson se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro.

Përveç kësaj një veprim i tillë sanksionohet edhe me nenin 24 paragrafi 9 nën paragrafi 9.1 Rregullës Nr.01/2024, ku përcaktohet se *“subjekti politik që është përfitues i fondeve për financimin e subjekteve politike përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës dënohet me gjobë deri në pesë dhjetëmijë (50,000.00)euro”*.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet për afërsisht të ngjashme.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11, nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nënparagrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 28/2025 më datë 15.01.2025

Kryesues i Panelit

Kujtim Pasuli



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.7/2025

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, Rrustem Thaqi dhe Ragip Namani, anëtarë, lidhur me ankesën Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.28/2025, të datës 15.01.2025, në seancën e mbajtur me datë, 20.01.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, A.nr.28/2025, të datës 15.01.2025.

A r s y e t i m i

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.28/2025, të datës 15.01.2025, është vendosur "I. Pranohet si e bazuar ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.28/2025, e datës 13.01.2025. II. Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 20,000.00 (njëzetmijë) €. III. Detyrohet Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartpërmendur, Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke mos i specifikuar shkaqet e ankesës, ndërsa si pretendim kryesor ankimor i saj është se gjoba është shqiptuar përtej kapaciteteve të përcaktuara nga KQZ për Financimin e Subjekteve Politike dhe nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit, duke propozuar që gjykata ta aprovoj ankesën si të bazuar, të rishikohet dhe rivlerësohet vendimi i kontestuar i PZAP A.nr.28/2025, të datë 15.01.2025, në kuptim të uljes së lartësisë së gjobës.



PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e Subjektit Politik të dënuar me këtë vendim, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi A.nr.28/2025, të datë 15.01.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 13.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), me të cilën pretendon se kandidatja për deputete nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, (LDK) Xheneta Syka, me anë të një shpërndarje të videos, ka krahasuar Kryeministrin Albin Kurti me njërin nga figurat më të urryera të historisë atë të Adolf Hitler, gjatë udhëheqjes të së cilit janë vrarë mbi 6 milionë njerëz të pafajshëm. Sipas parashtruesit të ankesës me këtë veprim kandidatja Xheneta Syka ka cenuar rëndë nenin 34. pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës, i cili shprehimisht thotë “përdorimi i gjuhës në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxis ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxis urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Me këtë parashtruesi i ankesës pretendon se kandidatja për deputete nga radhët e LDK-së Xheneta Syka, ka cenuar rëndë nenin 34 pika 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke përdorur gjuhë të urrejtjes kundër kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, njehërit Kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti.

Me datë 13.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 14.01.2025 në ora 12:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur më datë 14.01.2025, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje i cili pretendon se kandidatja për deputete nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, znj. Xheneta Syka, ka shkelur nenin 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 të LZP-së, nuk qëndron ngase origjina apo burimi i një fotoje të bashkangjitur në ankesën subjektit politik LVV, është e përpunuar dhe postuar nga krejt dikush tjetër (konkretisht një person me emrin Elena Uka) dhe jo nga kandidatja për deputete nga radhët e LDK-së, dhe se është një gabim në pretendim e që praktikisht i bie që nuk ka as shkelje të LZP-së dhe nenit të pretenduar e kësioj sigurisht se nuk mund të ketë as mase sanksionuese. Po ashtu në përgjigje në ankesë theksohet se në faqen zyrtare të kandidates për deputete nga LDK znj. Xheneta Syka nuk ekziston një foto e tillë, sepse ajo është e përpunuar dhe postuar nga një person krejt tjetër, çka vërehet edhe nga postimet e saj në faqen zyrtare të rrjetit social facebook dhe të cilat i kemi të bashkangjitura në përgjigje. Andaj, rrjedhimisht i propozoi PZAP-së që ankesën me numër



Anr.28/2025, të parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ndaj subjektit Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se ankesa është e bazuar, pasi që pas shikimit të bërë fotografisë së ofruar si provë materiale e cila është publikuar në rrjetin social të mbështetëses së subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, kandidatës për deputete Xheneta Syka nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, LDK, dhe me pas e njëjta fotografi është fshirë nga rrjeti social i kandidatës për deputete Xheneta Syka, por e njëjta foto nga hulumtimet e Panelit është gjendur se ekziston në portalin Peja në Fokus me linkun <https://www.instagram.com/reel/DEvfn-LtztU/?igsh=MTBIZnZ2NENzbGpicA->, prej nga rrjedh se mbështetësja e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK, me qëllim të etiketimit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje dhe promovimit të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka nxitur urrejtje ndaj subjektit politik LVV, në atë mënyrë që përmes rrjetit social ka publikuar, përkatësisht shpërndarjen në faqen e saj të rrjetit social video ku në këtë video, është bërë krahasimi i personalitetit të kryetarit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me figurën e Adolf Hitlerit. Paneli, konform nenit 13 par. 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 01/2014. me datë 14.01.2025, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara. Përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenit 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... 1) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".*

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë Kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit. Paneli, me rastin e vendosjes se gjohës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislationit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislationit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore. Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të vendimit të atakuar vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it si në



vendimin e tij, lidhur me dënimin e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se në mënyrë të sigurt është vërtetuar shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, e paraparë në nenin 34, 1.11, të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 24, pika 9.1 të Rregullores 01/2024 Për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës. Meqenëse ankuesi në ankesën e paraqitur nuk i është referuar shkeljeve konkrete të dispozitave të procedurës ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, por vetëm çështjeve që kanë të bëjnë me gjendjen faktike dhe lartësinë e gjobës së shqiptuar, Gjykata Supreme është kufizuar vetëm në trajtimin e këtyre pretendimeve ankimore.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të subjektit politik të lartpërmendur, përkitazi me konstatimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, ashtu si thekson parashtruesi i ankesës, mirëpo këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme. Kjo për faktin se PZAP, vendimin e atakuar e bazon në prova konkrete, të qarta dhe ekzistuese, siç është fotografia e ofruar si provë materiale, e cila është publikuar në rrjetin social të mbështetësës së subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, përkatësisht kandidates për deputete Xheneta Syka nga radhët e kësaj partie. Në anën tjetër, përkundër faktit se e njëjta fotografi është fshirë nga rrjeti social i kandidates për deputete Xheneta Syka, ka rezultuar e provuar nga ana e PZAP-it, se e njëjta është gjendur se ekziston në Portalin Peja në fokus, në linkun <https://www.instagram.cpm/reel/DEvfNLtzrU/?igsh=MTB1ZnZ2NENzbGpicA>.

Nga kjo rrjedh se mbështetësja, përkatësisht kandidatja për deputete e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK, me qëllim të etiketimit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje dhe promovimit të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka nxitur urrejtje ndaj subjektit politik LVV, në atë mënyrë që përmes rrjetit social ka publikuar, përkatësisht shpërndarjen në faqen e saj të rrjetit social video, në të cilën është bërë krahasimi i personalitetit të kryetarit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me figurën e Adolf Hitlerit. Nga kjo rezulton i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP-it, se me këto veprime është shkelur Kodi e Mirësjelljes dhe në veçanti neni 34. 1.11, i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ku parashihet se *"1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*.

Pretendimi ankimor se publikimi, përkatësisht shpërndarja e fotografisë së kontestuar, në të cilën bëhet krahasimi në mes figurës të kryetarit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me



fotografinë e Adolf Hitlerit nuk përmban gjuhë të urrejtjes, sepse kandidatja në fjalë nuk është prononcuar dhe nuk është material burimor i saj shkelje, është pretendim jo i bazuar. Kjo për faktin se krahasimi dhe qasja e kandidates së subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës ndaj kryetarit të një subjekti tjetër politik, në rastin konkret ndaj Albin Kurtit, me të drejtë është konstatuar nga PZAP-i se është me qëllim të denigrimit të personalitetit të tij, dhe mund të nxisë urrejtje, duke pasur parasysh figurën dhe të kaluarën e errët të Adolf Hitlerit në mbarë botën. Si rezultat i kësaj këto veprime të tilla vlerësohen se janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 34 pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), për çka edhe me të drejtë subjektit politik në fjalë i është shqiptuar gjoba në pajtim me dispozitën e nenit 120 parag.1, nën paragrafi 1.3 të LZP-së.

Gjykatës Supreme i rezulton se krahasimi i tillë, në kuadër të fushatës zgjedhore, paraqet shkelje të Kodit të Mirësjelljes dhe për këtë arsye e aprovon qëndrimin e PZAP-së, lidhur me shkeljen dhe lartësinë gjobës. Kjo për faktin se PZAP-i, me rastin e shqiptimit të gjobës së lartpërmendur, ka marr parasysh një mori rrethanash të precizuara më afër në arsyetimin e vendimit të tij, dhe se lartësia e gjobës e paraparë për një shkelje të tillë sipas nenit 120 paragrafi 1 pika 3, të Ligjit për zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nr.08-228, është deri në 50.000 €. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme vlerëson se gjoba e shqiptuar këtij subjekti politik në lartësi prej 20,000.00 €, është i drejtë dhe i ligjshëm, me të cilin vlerësohet se do të arrihet qëllimi ligjor i tij, përkatësisht jo vetëm ndëshkimi i shkelësve të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes të Subjektit Politik, Mbështetësve dhe Kandidatëve të tyre, por edhe korrektimi i shkeljeve të ndryshme zgjedhore dhe sigurimi i mbarëvajtjes së këtyre dhe zgjedhjeve, si dhe ndikimi edhe në subjektet e tjera politike që garojnë në zgjedhje, që me përpikëri të zbatojnë dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Kodin e Mirësjelljes. Në anën tjetër, rezulton se PZAP-i, me rastin e shqiptimit të gjobës, ka marr për bazë të gjitha rrethanat e përcaktuara në legjislacionin përkatës, përfshirë këtu shkallën dhe peshën e shkeljes dhe natyrën e shkeljes.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtresit të ankesës, prandaj, pretendimet në ankesë lidhur shkeljen e Kodit dhe me gjobën e shqiptuar u refuzuan si të pa bazuara, sepse si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakteve të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 120.1.3 dhe 34.1 (11), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME – PRISHTINË

AA.nr.7/2025, datë 20.01.2025



Republika e Kosovës



Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlasen radnik

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka